



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

POSTA SHQIPTARE SH.A

Tiranë, më 27.6.2025

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - mallra

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Blerje Pajisje Sigurie (Sisteme Alarmi, Sisteme Vezhg. Smart 4 CH, Sisteme Vezhg., Smart 8 CH, Ekrane video Wall, Sensor tymi dhe zjarri, UPS 1000W, UPS 3000 W, Tymuese dhome sigurie)”

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):
35113000-9**

VLERA E FONDIT LIMIT: 48,436,250 (dyzet e tetë milion e katërqind e tridhjetë e gjashtë mijë e dyqind e pesëdhjetë) **lekë pa TVSH.**

Në Eur: 495,511.51 (katërqind e nëntëdhjetë e pesë mijë e pesëqind e njëmbëdhjetë pike pesëdhjetë e një) Euro, pa TVSH

Kursi zyrtar i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë në datën 26.6.2025 është 97,75 Lekë/Euro

I.ARGUMENTIMI I MOS NDARJES NË LOTE

Në bazë të nenit 39 , të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” date 23.12.2020,i ndryshuar dhe nenit 42 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor “Posta Shqiptare” SH.A. ka vendosur qe kjo procedure te mos jete ne lote sipas arsytimit te meposhtem:

Kjo kontratë nuk është ndarë në lote pasi administrimi i saj, pra i gjithë bazës materiale objekt kontrate do të administrohet nga Drejtoria e Përgjithshme Posta Shqiptare SH.A, si dhe ndjekja dhe zbatimi i kontrates do të bëhet nga magazina e Drejtorisë së Përgjithshme, ndarja dhe frangmentimi i saj do të krijonte kompleksitet dhe vështirësi ne zbatim si dhe do e bënte të pazbatueshme kontratën.

Objekti i kontrates lidhet me furnizimin e **Blerje Pajisje Sigurie (Sisteme Alarmi, Sisteme Vezhg. Smart 4 CH, Sisteme Vezhg., Smart 8 CH, Ekrane video Wall, Sensor tymi dhe zjarri, UPS 1000W, UPS 3000 W, Tymuese dhome sigurie)** janë pasije të cilat vijnë

uniformë për zyrat për të plotësuar të gjithë standartin e sigurisë, për Filialet e Postës Shqiptare dhe Drejtorisë së Përgjithshme të cilat do të shpërndahen sipas kërkesave të drejtorive/sektoreve/zyrave përkatëse, si dhe çdo Filiali , Përsa më lart ndarja në lote do ta ndërlikonte dhe vështirësonte procesin e zbatimit të kontratës duke krijuar vonesa dhe rrjedhimisht do sillte vështirësi për stafin kërkues të bazës materiale. Kjo kontratë nuk mund të ndahet në lote pasi në thelb të gjithë artikujt objekt i kontratës i përkasin të njëjtës kategori produktesh.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (ndryshuar), autoriteti/enti kontraktor **Posta Shqiptare sh.a.**, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

Afatet e lëvrimit: Malli do të dorëzohet brenda **60 (gjashtëdhjetë) ditëve** kalendarike nga dita e nënshkrimit të kontratës mes paleve.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”(ndryshuar), autoriteti/enti kontraktor **SH.A. Posta Shqiptare**, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”(ndryshuar)

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

2.1.1 Operatori Ekonomik duhet të disponojë dhe paraqesë certifikata të vlefshme lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

- a) Standardin ISO 9001:2015 ose ekuivalente (e përditësuar), për sistemin e menaxhimit të cilësisë, objekti i të cilës të jetë në përputhje me objektin e prokurimit.
- b) Standardin ISO 27001:2022 ose ekuivalente (e përditësuar), për sistemin e menaxhimit të sigurisë së informacionit, objekti i të cilës të jetë në përputhje me objektin e prokurimit.

- c) Standardin ISO 20000-1:2018 ose ekuivalente (e përditësuar), për sistemin e menaxhimit të shërbimeve të Teknologjisë së Informacionit, objekti i të cilës të jetë në përputhje me objektin e prokurimit.

Shënim: Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, Certifikatat iso të kërkuara do të përmbushen nga i gjithë bashkimi, ku secili anëtar i bashkimit duhet të paraqesë certifikatat përkatëse të vlefshme sipas standardit ISO, në përputhje me natyrën e zërave që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt marrëveshjes.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme janë përcaktuar në mbështetje të nenit 77, 79 të Ligjit Nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, si dhe në mbështetje të nenit 44, pika 1 të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar) konkretisht:

“Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit...”

Argumentimi 2.3.7/a: Autoriteti Kontraktor ka përcaktuar kriterin kualifikues që Operatori Ekonomik të jetë i pajisur dhe të paraqesë në sistemin elektronik të prokurimit Standardin ISO 9001:2015 për menaxhimin e cilësisë, pasi ky standard garanton që operatori ka një sistem të strukturuar dhe të certifikuar për menaxhimin efektiv të proceseve dhe cilësisë së furnizimeve që ofron. Ky kriter është thelbësor për të siguruar që produktet dhe shërbimet që ofrohen janë në përputhje me kërkesat e prokurimit kombëtar dhe standardet ndërkombëtare. Gjithashtu, një certifikim i tillë i lëshuar nga një organ i akredituar ofron garanci për cilësinë dhe besueshmërinë e operatorit, duke minimizuar rrezikun e dështimeve dhe sigurimin e një vazhdimësie të qëndrueshme në projekt. Standardi ISO 9001:2015 promovon përmirësim të vazhdueshëm dhe është i njohur ndërkombëtarisht, duke rritur transparencën dhe sigurinë për përputhshmërinë e ofrimit të shërbimeve me nevojat dhe pritshmëritë e Autoritetit Kontraktor.

Argumentimi 2.3.7/b: Autoriteti Kontraktor ka kërkuar që Operatori Ekonomik të jetë i pajisur me Standardin ISO 27001:2022 ose ekuivalent, për sistemin e menaxhimit të sigurisë së informacionit, pasi ky standard ndërkombëtar garanton që operatorët ekonomikë kanë implementuar kontrole të sigurta dhe praktika të mira për menaxhimin e informacionit. ISO 27001:2022 siguron mbrojtjen e të dhënave sensitive, minimizon rreziqet e aksesit të paautorizuar, dhe garanton një qasje të strukturuar ndaj menaxhimit të sigurisë kibernetike. Duke qenë se objekti i prokurimit përfshin infrastrukturën e sigurisë, ky standard siguron që operatorët ekonomikë të kenë kapacitetin dhe kompetencat për të trajtuar sfidat e sigurisë.

Argumentimi 2.3.7/c: AK ka kërkuar që Operatori Ekonomik të paraqesë certifikimin ISO 20000-1:2018 për sistemin e menaxhimit të shërbimeve të Teknologjisë së Informacionit, pasi ky standard është një garanci e cilësisë së ofrimit të shërbimeve në fushën e IT-së. Ky certifikim vërteton se Operatori Ekonomik ka zbatuar praktikën më të mirë në menaxhimin dhe ofrimin e shërbimeve IT, përfshirë planifikimin, realizimin, monitorimin dhe

përmirësimin e vazhdueshëm të tyre. Duke u bazuar në një standard ndërkombëtar të njohur, si ISO 20000-1:2018, Autoriteti Kontraktor sigurohet që shërbimet e teknologjisë së informacionit të ofruara nga O.E të jenë në përputhje me kërkesat e prokurimit, duke garantuar cilësi, efektivitet dhe përputhshmëri me standardet më të fundit të industrisë.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore financiare të 3 (tre) viteve të fundit, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo më e vogël se 99% e vlerës së fondit limit**. *Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, pra 99% e vlerës së fondit limit, në të paktën 1(një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2020 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohej, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrisë të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

AK në miratimin e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore”: “Çdo tatimpagues përgatit deklaraten vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrisë të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaraten vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrisë të Financave në zbatim të këtij ligji.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 39 % të vlerës së përlllogaritur të kontratës, që prokurohet.

Autoriteti/enti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasitë e mallrave të furnizuara.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruar në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasisë e mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën me sukses, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 39 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Pasi vlera e parashikuar e kontratës, është mbi kufirin e lartë monetar. Vlera për shërbime të ngjashme përbën një nivel të mjaftueshëm përvojë duke patur parasysh objektin dhe vlerën e kontratës.

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e kontratave të ngjashme që mund të kërkohet, autoritete/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të kontratave të ngjashme brenda këtij marzhi.

Përvoja e mëparshme është një element shumë i domosdosshëm që garanton autoritetin kontraktor se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së kontratave të ngjashme zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie. Në mbështetje të nenit 88 pika 1 e VKM 285/2021, parashikon se “Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, sipas përcaktimit të pikave 2 dhe 3, të nenit 14, të LPP-së, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe, në rast përzgjedhjeje, edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi nëpërmjet një kontrate bashkëpunimi të hartuar ndërmjet palëve.

2.3.2. Operatori Ekonomik për të realizuar furnizimin, instalimin, integrimin me sistemet ekzistuese të mallrave objekt prokurimi, duhet të ketë të punësuar minimalisht një staf prej 10 (dhjetë) punonjësish. Për të plotësuar këtë kriter duhet të paraqesë vërtetim nga Drejtoria e Tatimeve për numrin e punonjësve të siguruar për periudhën jo më pak se 3 (tre) muajt e fundit të maturuara nga data e hapjes së tenderit, shoqëruar me listë pagesat e sigurimeve shoqërore (formularët E-sig 025 a) për këtë periudhë të konfirmuara nga organet tatimore. Nga të cilët:

- 1 (një) Inxhinier elektronik, për të cilin operatori ekonomik të paraqesi diplomën përkatëse ose vërtetim diplomë, dhe të figurojë në listëpagesa për periudhën e kërkuar.

- 1 (një) Specialist TIK (Teknologji Informacioni dhe Komunikimi)/Informatike për të cilin operatori ekonomik të paraqesi diplomën përkatëse ose vërtetim diplome dhe të figurojë në listëpagesa për periudhën e kërkuar. Do vlerësohet si kriter i përmbushur edhe paraqitja e diplomave ekuivalente si Informaticient;
- 1 (një) Inxhinier Elektrik për të cilin operatori ekonomik të paraqesi diplomën përkatëse ose vërtetim diplome dhe të figurojë në listëpagesa për periudhën e kërkuar;
- 1 (një) punonjës të certifikuar në Menaxhimin e Projekteve Profesionale (Project Management Professional – P M P, PRINCE 2) lëshuar nga Project Management Institute (P M I) ose ekuivalente, për të cilin operatori ekonomik të paraqesi certifikatën përkatëse dhe të figurojë në listëpagesa për periudhën e kërkuar;
- 4 (katër) punonjës të certifikuar si montues të pajisjeve elektronike ose ekuivalent të cilët të vërtetohen nga operatori ekonomik nëpërmjet kodit përkatës të profesionit të deklaruar në listëpagesat e 3-mujve të fundit;
- 2 (dy) punonjës të certifikuar/trajnuar nga kompania prodhuese e sistemeve të kamerave, ose ekuivalente, e vërtetuar me certifikatën përkatëse dhe të figurojnë në listëpagesat e sigurimeve shoqërore për periudhën e kërkuar;
- 2 (dy) punonjës të certifikuar/trajnuar nga kompania prodhuese e sistemeve të alarmeve, ose ekuivalente, e vërtetuar me certifikatën përkatëse dhe të figurojnë në listëpagesat e sigurimeve shoqërore për periudhën e kërkuar;

**(sqarim: lidhur me certifikimet një punonjës mund të zotërojë më shumë se një certifikim të kërkuar për të përmbushur kriterin)*

Shënim: Ky kriter do të konsiderohet i përmbushur nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 8 të DST. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për t'u kërkuar sqarime nga Autoriteti Kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 4 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenit 40, pika 5, të VKM nr.

285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar). Specialistët e kërkuar janë të nevojshëm për instalimin, integrimin, konfigurimin dhe vendosjen në punë të sistemeve objekt-prokurimi. Dokumentacioni i kërkuar për punonjësit është i nevojshëm për të provuar që është i diplomuar në një nga fushat e kërkuara dhe është në marrëdhënie pune pranë operatorit/ve ekonomikë ofertues. Nga ana e AK është kërkuar një numër punonjësish prej 10 personash, sepse kontrata është komplekse, me shume artikuj ku kërkohen punonjës të specializuar në procese specifike të furnizimit/intsalimit dhe integritit me sistemet ekzistuese te mallrave objekt prokurimi.

Të gjithë artikujt janë parashikuar të jenë Furnizim Vendosje, pra përveç furnizimit dhe shpërndarjes kemi të përfshirë edhe procesin e montimit që kërkon punonjës të tjerë duke patur parasysh edhe faktin që kemi të bëjmë me zyra postare/dege/ filiale që gjenden te pozicionuara ne te gjithë territorin e vendit.

Kërkesa për staf është hartuar në përputhje me VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Neni 40, pika 5, (i ndryshuar).

Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

a) *licenca profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose*

b) *një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose*

c) *fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose*

ç) *mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën....”*

Bazuar në objektin e prokurimit, Inxhinieret dhe montuesit /tekniket e pajisjeve elektronike janë personat e drejtpërdrejtë që do të angazhohen nga O.E në instalimin e pajisjeve, konfigurimin e tyre dhe integrimin në rrjetet ekzistuese ndaj certifikimi nga prodhuesi i pajisjeve që do të instalojnë, konfigurojnë dhe mirembajnë.

- 1 (nje) inxhinier elektronik – Ky kriter është i nevojshëm pasi inxhinieri elektronik është personi që do të angazhohet drejtpërdrejtë në mbikqyrjen e proceseve të instalimit të kamerave të cilat janë pajisje elektronike dhe gjithashtu do të asistojë AK në rast defektesh gjatë periudhës së garancisë.
- 1 (nje) Specialist TIK (Teknologji Informacioni dhe Komunikimi)/Informatike-- Ky kriter është i nevojshëm pasi Specialisti Tik do të jetë personi përgjegjës për integrimin e të gjithë sistemeve në platformat ekzistuese te AK.
- 1 (nje) Inxhinier Elektrik— Ky kriter është i nevojshëm pasi inxhinieri elektrik është personi i cili do të mbikqyrë dhe drejtojë të gjithë proceset dhe lidhjet e nevojshme me rrjetin e energjisë elektrike dhe do të garantojë zbatimin e rregullave teknike sipas ligjit Nr. 8734 datë 01.02.2001 “ Për garantimin e sigurisë së punës së pajisjeve dhe instalimeve elektrike”, indryshuar.
- 1 (nje) punonjes te pajisur me Certificate per Menaxhim Projektesh— Ky kriter i jep garanci AK se operatori ekonomik ka në staf një person të certifikuar dhe me eksperiencë që do të jetë i angazhuar në menaxhimin e kontratës , ndarjen e punëve, mbajtjen e kontakteve me AK , zbatimin e përpiktë të grafikut të ekzekutimit etj. Një menaxher projekti me certifikim në nivel profesional dëshmon aftësi të specializuara për të ndjekur një qasje metodike, e cila përfshin planifikimin e saktë të burimeve, menaxhimin e riskut, organizimin dhe koordinimin efektiv të ekipeve teknike, si dhe

monitorimin e vazhdueshëm të performancës së projektit. Këto aftësi sigurojnë që projektet komplekse të realizohen brenda afateve të përcaktuara dhe në përputhje me kërkesat e Autoritetit Kontraktor.

- Minimumi 4 (kater) punonjës të siguruan si montues të pajisjeve elektronike ose profesione ekuivalente - referuar vkm nr. 514, datë 20.9.2017 “Për miratimin e listës kombëtare të profesioneve (lqp)” të rishikuar, montuesit/teknikët do të jenë personat e drejtpërdrejtë që do të angazhohen në kryejren e punimeve për furnizim-vendosjen e sistemeve të vezhgimit, sistemeve të alarmit, etj.
- 2(dy) punonjes të certifikuar nga kompania prodhuese e sistemeve të kamerave, ose ekuivalente, e vertetuar me certifikaten perkatese dhe të figurojnë në listepagesat e sigurimeve shoqerore për periudhën e kerkuar;- Trajnimi/Certifikimi nga prodhuesi është garanci për AK se këta persona janë të aftë dhe kanë eksperiencën e nevojshme për të realizuar instalimin e pajisjeve brenda afatit të realizimit të kontratës pasi kanë marrë të gjithë njohuritë e nevojshme për produktet që do të montojnë.
- 2 (dy) punonjes të certifikuar nga kompania prodhuese e sistemeve të alarmeve, ose ekuivalente, e vertetuar me certifikaten perkatese dhe të figurojnë në listepagesat e sigurimeve shoqerore për periudhën e kerkuar;- Trajnimi/Certifikimi nga prodhuesi është garanci për AK se këta persona janë të aftë dhe kanë eksperiencën e nevojshme për të realizuar instalimin e pajisjeve brenda afatit të realizimit të kontratës pasi kanë marrë të gjithë njohuritë e nevojshme për produktet që do të montojnë.

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të paraqesë Autorizim të prodhuesit/ve ose Distributorit të autorizuar prej prodhuesit për furnizimin e listës së artikujve (të jetë e përfshirë specifikisht edhe licenca përkatëse) si më poshte:

- **SISTEM ALARMI ME TË GJITHË PJESET PERBERESE SIPAS SPECIFIKIMEVE TEKNIKE ;**
- **NVR 4 KANALE ;**
- **NVR 8 KANALE;**
- **KAMERA E JASHTME INTELIGJENTE 8 MPX ;**
- **KAMERA E BRENDSHME INTELIGJENTE 8 MPX ;**
- **UPS 1000 W ;**
- **UPS 3000W;**
- **SENSOR TYMI DHE ZJARRI;**
- **TYMUESE PER DHOME SIGURIE**

Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, website, kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij kurse në rastin e Autorizimit nga Distributori i Autorizuar do të paraqitet dhe akt-marreveshja/akti perkates.

Argumentimi: Ky kriter është në përputhje me nenin 77, pika 4, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pikën 6,8 të nenit 40, të V.K.M-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar Autorizimi i prodhuesit ose distributorit të autorizuar është një dokument i rëndësishëm, pasi përveç se tregon origjinën e mallrave që kërkohen në procedurë, na garanton se ofertuesi është i autorizuar për ofrimin tek AK të këtyre mallrave. Ky kriter është në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës dhe lidhet drejtpërdrejtë me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë e OE ofertues për aftësitë teknike

2.3.4 Për të vërtetuar përputhshmërinë me specifikimet teknike, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë kataloget/skedat teknike (datasheet) nga prodhuesi i mallrave që oferton , te perkthyer dhe noterizuara sipas ligjit , për produktet si më poshtë:

- **SISTEM ALARMI ME TE GJITHE PJESET PERBERESE SIPAS SPECIFIKIMEVE TEKNIKE ;**
- **NVR 4 KANALE ;**
- **NVR 8 KANALE;**
- **KAMERA E JASHTME INTELIGJENTE 8 MPX ;**
- **KAMERA E BRENDSHME INTELIGJENTE 8 MPX ;**
- **UPS 1000 W ;**
- **UPS 3000W;**
- **SENSOR TYMI DHE ZJARRI;**
- **TYMUESE PER DHOME SIGURIE**

Argumentimi : Ky kriter është në përputhje me nenin 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe të nenit 40, pika 6 b, të V.K.M-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Paraqitja e katalogëve apo skedave teknike për artikullin që është objekt prokurimi, është kërkuar me qëllim verifikimin e përputhshmërisë të artikujve që operatori ekonomik oferton me specifikimet teknike të percaktuara.

2.3.5 Operatori ekonomik duhet të provojë që produktet e ofertuara (sistemet e alarmit, sistemet e vëzhgimit) mund të integrohen në programet ekzistuese të monitorimit që ka Posta Shqiptare sh.a ne përdorim (HIK Central, KronosNet). Për përmbushjen e këtij kriteri operatorët ekonomik duhet të paraqesin një Deklaratë/Vërtetim nga prodhuesi i pajisjeve që pajisjet e ofertuara mund të funksionojnë me të gjitha parametrat e kërkuara në këto programe.

Argumentimi: Ky kriter është në përputhje me nenin 77, pika 4, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pikën 6,8 të nenit 40, të V.K.M-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar
Sistemet e sigurisë ndonëse do instalohen në pika të ndryshme të vendit në të cilat funksionojnë degët/filialet e Posta Shqiptare sh.a , do të integrohen me sistemet ekzistuese dhe do të transmetojnë në Sallën Qendrore të Monitorimit në Drejtorinë e Përgjithshme në Tiranë ndaj AK duhet të ketë një garanci kompatibilitetit me infrastrukturën ekzistuese.

2.3.6 Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë për periudhën e garancisë së artikujve jo më pak se 1 (një) vit nga data e dorëzimit të artikujve objekt prokurimi, gjatë së cilës ofertuesi do të sigurojë riparimin, mirëmbajtjen dhe shërbimin pa pagesë, të defekteve për shkak të prodhimit dhe montimit.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar.

Ky kriter vendoset për të garantuar përmbushjen e detyrimeve nga operatori ekonomik në përputhje me specifikimet dhe kërkesat e Autoritetit Kontraktor.

2.3.7 Operatori Ekonomik duhet të disponojë **3 (tre) automjete** për realizimin e instalimeve, për të cilët duhet të paraqesë dokumentat e mëposhtëm:

- Lejen e qarkullimit
- Policën e sigurimit

- Certifikaten e kontrollit teknik
- Taksat vjetore

Në rast se mjetet e lartpërmendura janë marrë me qira ofertuesi duhet të paraqesë **Kontratën e marrjes me qira të mjetit**, shoqëruar me dokumentacionin përkatës të pronësisë së mjetit që ka pronari, i cili e jep me qira. Kontrata e qirasë të jetë noteriale e të përfshijë afatin e realizimit të kësaj kontrate.

Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojces Nr. 9, të DST-ve dhe në zbatim të V.K.M – së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, neni 26 “Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit”, pika 6 “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese”.

Argumentimi: Ky kriter, është në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës dhe tregon që ofertuesi ka kapacitetet e nevojshme për realizimin me sukses të kontratës. Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 40, pika 5 germa ç, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Kërkesa e mesiperme i shërben AK si garanci se operatori ekonomik fitues ka mjetet e nevojshme për të realizuar me sukses implementimin e kontratës brenda afateve.

Sqarim! Të gjitha kriteret e sipërcituara në **Shtojca 8, të DST-së**, të cilat përfshihen në përcaktimet e pikës 1, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, ku parashikohet: “*Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas Shtojca 9, të DST-së, do të vlerësohen të përmbushura në fazën e vlerësimit të ofertave të ofertuara në SPE.*”

Referuar përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, si dhe përcaktimet e pikës 6, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, ku parashikohet: “Në çdo rast, përpara se të japë kontratën, autoriteti/enti kontraktor duhet t’i kërkojë ofertuesit fitues që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin...”, Ofertuesi fitues, përpara lidhjes së kontratës duhet të paraqesë në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike të procedurës për Specifikimet teknike të procedurës për “**Blerje Pajisje Sigurie (Sisteme Alarmi, Sisteme Vezhg. DVR AUTO, Sisteme Vezhg. DVR/NVR 4 kamera, Sisteme Vezhg. DVR/NVR 8 kamera, Sisteme Vezhg. DVR/NVR 16 kamera, Pajisje GPS)**”, janë hartuar mbi bazën e Urdhërit Nr. 24, datë 25.04.2025, të Administratorit të Posta Shqiptare sh.a., në përputhje me nenin 4, pika 38/b

dhe nenin 36, të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, si dhe nenit 44, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (ndryshuar).

Specifikimet teknike shprehin tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe në përputhje të plotë me funksionet e kërkuara nga Autoriteti Kontraktor.

VLERA LIMIT E KONTRATËS,

Vlera Limit e kontratës, duke qenë se nuk ka çmime të botuara nga INSTAT-i, ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse, grupi i punës i ngritur me urdhërin e administratorit **nr. 30**, datë **12.05.2025**, u bazua në çmimet e tregut, e bazuar në nenin 76

“Mënyrat për përllogaritjen e vlerës së prokurimit”, të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimeve Publike” (i ndryshuar) ku parashikohet se:

1. Në përllogaritjen e vlerës limit të kontratës, autoriteti/enti kontraktor duhet t’i referohet një ose më shumë alternativave të renditura, si më poshtë vijon:

- a) çmimet e botuara nga Instituti i Statistikave (INSTAT), ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, dhomat e tregtisë, në manuale etj.); ose/dhe*
- b) **studimit të tregut**, bazuar në mesataren e çmimeve të marra nga ky studim; ose/dhe*
- c) çmimet e kontratave të mëparshme, të realizuara nga vetë apo nga autoritete të tjera kontraktore; ose/dhe*
- ç) çmimet ndërkombëtare të shpallura publikisht.*

Autoriteti/enti kontraktor mund t’i referohet një ose më shumë alternativave të mësipërme në përllogaritjen e vlerës limit të kontratës, me qëllim që ajo të jetë një vlerë reale për kushtet e tregut dhe njëkohësisht të krijojë mundësinë e pjesëmarrjes së sa më shumë operatorëve ekonomikë.

*Bazuar në germen b) të pikes 1, të nenit 76 “Mënyrat për përllogaritjen e vlerës së prokurimit”, të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimeve Publike” (i ndryshuar), grupi i punës, ka realizuar **studimin e tregut**, bazuar në mesataren e çmimeve të marra nga ky studim; dokumentacion i cili gjendet në dosjen e tenderit dhe ka përllogaritur vlerën limit të kontratës.*

Specifikimet teknike fondi limit dhe kriteret e vecanta per kualifikim jane hartuar nga strukture e posacme e ngritur me urdher te titullarit te autoritetit kontraktor.

NJËSIA E PROKURIMIT